# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-459376**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Atentat në Sarandë/ Viktima Artan Myrtaj, i përfshirë në plagosjen e dy personave. Si nisi saga e hakmar rjes \| |
| ADRESA | `https://boldnews.al/2026/09/20/1736797/` |
| BURIMI | boldnews.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 20 shtator 2026, 08:45:49 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 20 shtator 2026, 08:44:43 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `025f301ee4960172819c94cdcbd051c80628e6502781abec061dd255c9639e43` |
| TEKSTI | `685106b560e6a4e7e8592d2f5b6f37d35337f6823d4cb5d92c9537f4748d2829` |
| PAMJA | `bfe488bfe1306fdda0485a0196e5791ecb2c15d62128c38191cd3067367ec26b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `6a6d6de4a6239b7bd3c4d65b13972b35d089b8d59e3ef4e3b92551893aa0bc01` |
| E MËPARSHMJA | `982e20afe333c04ef40e91a908cf7a27d68ddb278073994019acdeae4bcc707b` |
| RRËNJA MERKLE | `7843691d73f82da58f46c5c712d0bec6679deb0584938ea073db401557569169` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/6a6d6de4a6239b7bd3c4d65b13972b35d089b8d59e3ef4e3b92551893aa0bc01`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Atentat në Sarandë/ Viktima Artan Myrtaj, i përfshirë në plagosjen e dy personave. Si nisi saga e hakmarrjes

10:44 : 20/09/2026 në **AKTUALITET, KRONIKE, KRYESORE**




Një atentat me armë zjarri tronditi mëngjesin e sotëm qendrën e Sarandës, pranë ish-agjencisë së vjetër, ku për pasojë humbi jetën 44-vjeçari **Artan Myrtaj,** i njohur ndryshe si "Tani Ruzhdiut".

Sipas policisë ngjarja ka ndodhur rreth orës 09:55, teksa nga të shtënat mbeti i plagosur edhe një kalimtar rasti, Xhevdet Skëndaj i cili raportohet se është transportuar për ndihmë mjekësore.

Ngjarja ka ndodhur në një zonë të frekuentuar të qytetit, ndërsa autorët dyshohet se kanë ndjekur viktimën dhe kanë qëlluar me armë zjarri.

Sipas informacioneve paraprake, bëhet fjalë për dy persona që lëviznin me motor dhe mbanin skafandra, çka e ka bërë më të vështirë identifikimin e tyre.

Pas të shtënave, autorët janë larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes ndërsa policia thotë se janë ngritur pika kontrolli në drejtim të Vlorës dhe të Gjirokastrës me qëllim kapjen e tyre.

**Lexo edhe:**

Vrasja e 44-vjeçarit në Sarandë/ Policia: I plagosur dhe një kalimtar, pika kontrolli për kapjen e autorëve

Del FOTO e Artan Myrtajt që iu bë atentat në Sarandë, viktima sapo ishte liruar nga burgu



**TË GJITHA**


Vrasja e 44-vjeçarit në Sarandë/ Policia: I plagosur dhe një kalimtar, pika kontrolli për kapjen e autorëve
11:06 : 20/09/2026


Atentat në Sarandë/ Viktima Artan Myrtaj, i përfshirë në plagosjen e dy personave. Si nisi saga e hakmarrjes
10:44 : 20/09/2026


Del FOTO e Artan Myrtajt që iu bë atentat në Sarandë, viktima sapo ishte liruar nga burgu
10:43 : 20/09/2026


U vra me armë zjarri në Sarandë, Artan Myrtaj rezulton i arrestuar në 2025
10:26 : 20/09/2026


EMRI/ Vrasja në Sarandë, zbulohet identiteti i viktimës
10:13 : 20/09/2026


Vrasje me armë zjarri në Sarandë
10:05 : 20/09/2026


Kontrabandë mallrash nga Greqia, arrestohen 2 persona në Gjirokastër
09:48 : 20/09/2026



Viktima, Artan Myrtaj

**Myrtaj, i përfshirë në një tjetër ngjarje të rëndë në Sarandë**

Emri i Artan Myrtajt ishte bërë i njohur më herët për policinë dhe organet e drejtësisë, pasi rezulton i përfshirë në hetimet për një ngjarje të ndodhur më 17 korrik 2025, në lagjen nr. 4 të Sarandës.

Në atë episod, me armë zjarri u plagosën Ernest Lama dhe Gëzim Hajdaraj, të dy nga Kamza.

Sipas të dhënave të dosjes së hetimit, autor i dyshuar i plagosjes ishte Ramadan Zoto, ndërsa Artan Murtaj, Klaus Jaçaj dhe Erjon Canaj dyshohet se e kanë ndihmuar atë gjatë ngjarjes dhe në largimin nga vendi.

Myrtaj dhe Jaçaj ishin proceduar për veprën penale të "përkrahjes së autorit të krimit" dhe, sipas të dhënave të bëra publike për çështjen, ishin liruar para pak kohësh.

Ndërkohë, Ramadan Zoto ndodhet në burg për plagosjen e Lamës dhe Hajdarajt, ndërsa Erjon Canaj vijon të jetë në kërkim.

**Seria e hakmarrjeve pas plagosjes**

Pas ngjarjes së korrikut 2025, në Sarandë u regjistruan edhe episode të tjera kriminale, të cilat u lidhën në atë kohë me një zinxhir të mundshëm hakmarrjesh.

Një prej ngjarjeve më të rënda ishte vrasja me lëndë plasëse e Isuf Jaçajt, babait të Klaus Jaçajt. Në një tjetër episod u raportua edhe për dëmtimin e pronës së Ramadan Zotos.

Hetuesit pritet të verifikojnë nëse atentati i mëngjesit të sotëm lidhet me konfliktet e mëparshme apo nëse bëhet fjalë për një ngjarje me motiv tjetër. Në këtë fazë, motivi i atentatit nuk është bërë zyrtarisht i ditur.

**Etiketa:** Artan Myrtaj atentat sarande


Lajme të lidhura



Vrasja e 44-vjeçarit në Sarandë/ Policia: I plagosur dhe një kalimtar, pika kontrolli për kapjen e autorëve

11:06 : 20/09/2026



Del FOTO e Artan Myrtajt që iu bë atentat në Sarandë, viktima sapo ishte liruar nga burgu

10:43 : 20/09/2026



U vra me armë zjarri në Sarandë, Artan Myrtaj rezulton i arrestuar në 2025

10:26 : 20/09/2026




EMRI/ Vrasja në Sarandë, zbulohet identiteti i viktimës



Vrasje me armë zjarri në Sarandë



Përleshje me grushte e thika/ Del VIDEO e sherrit me 3 të plagosur


10:13 : 20/09/2026

10:05 : 20/09/2026

në Sarandë

22:47 : 17/09/2026

BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.
Na kontakto: [email protected]

NA NDIQ

2026 Boldnews Dev By Techzero1.com

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.